



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 120, datë 05.03.2020

PËR

MIRATIMIN E “FORMULARIT TË INTEGRUAR TË VLERËSIMIT TË GJYQTARIT”

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 147, pika 1 shkronja “a” të Kushtetutës, nenet 2, 68-72, 74-78, 84-95, 97 dhe 171 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Rregulla plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.264, datë 19.12.2019 “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Formularit të integruar të vlerësimit të gjyqtarit”, sipas formatit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. “Formulari i integruar i vlerësimit të gjyqtarit” hartohet në format shkresor dhe/ose elektronik, të cilët kanë vlerë të njëjtë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR